



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
DREJTORIA RAJONALE E TRASHËGIMISË KULTURORE BERAT

ANALIZA VJETORE 2025

Në kuadër të realizimit të objektivave për vitin 2025, DRTK Berat ka qenë e fokusuar në përmbushjen e qëllimit madhor që ky institucion ka:

Ruajtja, konservimi, mirëmbajtja dhe restaurimi i monumenteve të kulturës si edhe promovimi i vlerave të Trashëgimisë Kulturore materiale dhe jomateriale në territorin administrativ nën juridiksionin e DRTK Berat.

1. PROJEKTE TË HARTUARA NGA DRTK BERAT

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2025, nga ana e DRTK Berat së janë hartuar dhe më pas miratuar projektet si më poshtë:

NR	EMËRTIMI I OBJEKTIT	PERIUDHA	VLERA E PREVENTIVUAR	KESHILLI QE I KA MIRATUAR (DT, NR)	HARTUESIT E PROJEKTIT
1	Projekt Restaurimi “Rrënojat e Urës së Palecit”, fshati Tozhar, Poliçan, monument kulture kat. I-rë.	Janar-Qershor		Përfunduar	DRTK Berat
2	Projekt restaurimi dhe konservimi në muret e Kalasë, segmenti kulla 23-24 dhe nga kulla 24 (kulla e fundit) deri në kullën 1 dhe kurtinave midis tyre, në Kalanë e Beratit.	Janar-Shkurt		Përfunduar	DRTK Berat
3	Hartim i projektit “Mirëmbajtje dhe konsolidim të mureve dhe strehës së çatisë në	Janar-Korrik			



	kishën e Shën Mëhillit, Mangalem, kat. I.			Përfunduar	DRTK Berat
4	Projekt restaurimi dhe konservimi i kishës së Shën Kollit në Perondi, Kuçovë, Berat monument kulture kategoria e parë.	Janar-Dhjetor		Në proces aplikimi	DRTK Berat në bashkëpunim me IKTK Tiranë.
5	Hartim i “Paketës së punimeve emergjente parandaluese (konservim, restaurim, mirëmbajtje) në qytetin e Beratit e përreth. (Paketa 2025).	Mars-Dhjetor		Përfunduar	DRTK Berat
6	Hartim projekti për ndërhyrje emergjente në banesën Nikolla Manestra, kat. I, lagjja Goricë.	Janar-Shkurt		Përfunduar	DRTK Berat
7	Hartimi i projektit të ndërhyrjeve restauruese në xhaminë e Vokopolës, monument kulture, kategoria e parë.	Janar-Dhjetor		Në proces për riaplikim.	DRTK Berat
8	Hartimi i projektit “Konservimi, restaurimi dhe përshtatje e gjurmës së kishës së “Fjetja e Shën Marisë” në hyrje të lagjes Mangalem.	Qershor-Dhjetor		Në proces për plotësim dokumentacioni	DRTK Berat
9	Hartimi i projektit “Restaurim çatie në banesën e z.Albert	Shtator-Dhjetor			



	Ndrio, lagjja Goricë”, monument kulture kat,II.			Në proçes aplikim	DRTK Berat
10	Hartim i “Paketës së punimeve emergjente parandaluese (konservim, restaurim, mirëmbajtje) në qytetin e Beratit e përreth. (Paketa 2025 - 2).	Dhjetor		Në proçes aplikim	DRTK Berat
11	Hartimi i projektit “Restaurim çatie në banesën e Znj. Liza Kote”, lagjja Kala monument kulture kat,II.	Dhjetor		Në proçes aplikim	DRTK Berat

2. REALIZIMI I BUXHETIT PER VITIN 2025

a. Projekte të financuara nga buxheti i shteti dhe te zbatuara (231)

Nr	Emërtimi i objektit	Periudha	Vlera e financimit	Produkti i përfituar (përshkrim narativ)
1	PROJEKT KONSERVIMI & RESTAURIMI KULLAT NR. 23-24, 24-1, KURTINAT MIDIS TYRE DHE OBORRI I FORTIFIKUAR (KALAJA E BERATIT) FAZA I	TETOR 2025-DHJETOR 2025	5,335,999	Restaurimi, pastrimi, konsolidimi dhe mirembajtje e kullave dhe murreve te Kalase se Beratit, duke permiresuar gjendjen e tyre dhe rritjen e aksesit nga ana e vizitoreve.
2	BLERJE SKELERIE	DHJETOR 2025	189,000	Skeleri e nevojshme për punimet restauruese te realizuara nga Drejtoria



b. Projekte të financuara nga buxheti i shteti (602)

NR	EMËRTIMI I OBJEKTIT	PERIUDHA	VLERA E FINANCIMIT	STATUSI I NDERHYRJES
1	Restaurim i dy ikonave “Krishti” dhe “Shën Mëria” me autor Vëllezërit Çetiri.	Janar-Maj	99.200 lekë	Përfunduar
2	Mirëmbajtje e strehës së portës hyrëse në banesën e Z. Harmanak Badajani, monument kulture kategoria e dytë, lagjja Mangalem. (Pjesë e Paketës së Mirëmbajtjes).	Janar	10.046 lekë	Përfunduar
3	Mirëmbajtje në fasadën e banesës së familjes Prroj, monument kulture kategoria e parë, lagjja Goricë.	Janar-Shkurt	13.881 lekë	Përfunduar
4	Mirëmbajtje e portës hyrëse në banesën e Znj. Olimbi Zanati, monument kulture kategoria e dytë, lagjja Goricë.	Shkurt	21.370 lekë	Përfunduar
5	Mirëmbajtje në çatinë e banesës së familjes Droboniku, monument kulture kategoria e dytë, lagjja Mangalem.	Shkurt	Materialet u siguruan nga pronari	Përfunduar
6	Restaurim i portës në banesën e familjes Xhimitiku, monument kulture, kategoria e parë, lagjja Goricë.	Mars	47.934 lekë	Përfunduar



7	Mirëmbajtje e tabelave informuese për monumentet kategori e parë në Qendrën Historike.	Mars	98.784 lekë	Përfunduar
8	Mirëmbajtje në Katedralen Fjetja e Shën Mërisë sot muzeu Onufri.	Mars	90,419 lekë	Përfunduar
9	Ndërhyrje restauruese në banesën e Z. Ëngjell Koço, monument kulture kategori e dytë në lagjen “Kala”, faza përfundimtare restaurim fasade	Mars	4.293 lekë	Përfunduar
10	Restaurim dhe konservim i afreskut ne kishen e Shen Triadhës, lagjja Kala,Berat.	Mars-Gusht	95.000 lekë	Përfunduar
11	Ndërhyrje emergjente në kishën e Shën Todrit në lagjen Kala, pjesë e Paketës së Mirëmbajtjes .	Mars-Prill	31.784 lekë	Përfunduar
12	Restaurim tavanesh në banesën Heqimi, monument kulture kat.I, lagjja Mangalem, pjesë e Paketës së Mirëmbajtjes.	Maj-Tetor	212.117 lekë	Përfunduar
13	Ndërhyrje emergjente në banesën e z.Nikolla Manestra, G 075/b, lagjja Goricë, Berat, kat.I.	Maj-Korrik	15.032 lekë	Përfunduar restaurimi i murit të gurit.



14	Dezinfektimi i veprave të artit (ikonave) pranë laboratorit të restaurimit të veprave të artit të DRTK Berat.	Maj-Qershor		Përfunduar
15	Ndërhyrje mirëmbajtje në strehën e banesës Merdani, pjesë e Paketës së Mirëmbajtjes.	Maj-Qershor	12.323 lekë	Përfunduar
16	Mirëmbajtje e shkallëve prej guri në itinerarin që të çon te tabja në kalanë e Beratit.	Gusht	10.565 lekë	Përfunduar
17	Ndërhyrje mirëmbajtje në kishën e Shën Marisë, Sinjë. (Pastrimi i muraturës së gurit nga gëlqerja).	Tetor-Dhjetor	27.456 lekë	Përfunduar
18	Ndërhyrje emergjente në muraturën e gurit midis banesave K-099 dhe K-098/b lagjja Kala.	Tetor	8.497 lekë	Përfunduar
19	Ndërhyrje emergjente në murin e gurit në rrugicën “Dhimitër Kajana”, lagjja Kala.	Nëntor	2.807 lekë	Përfunduar
20	Mirëmbajtje e portës hyrëse të kishës së Shën Thomait, lagjja Goricë, Berat.	Dhjetor	2250 lekë	Përfunduar
21	Ndërhyrje emergjente në murin e gurit në rrugicën “Mbrica”, lagjja Kala.	Dhjetor	4.533lekë	Përfunduar



Përveç punimeve të mirëmbajtjes të listuara më sipër, gjatë vitit 2025 janë realizuar pastrime nga vegetacioni në 60 objekte dhe në Qendër Historike.

c.Kontratat e prokurimit të nënshkruara dhe të realizuara

Lista e Kontratave të Prokurimit

- Kontratë Prokurimi me objekt “**Blerje Karburanti**”
 - Vlera Totale e Kontrates : 659 971 Lekë me Tvsh.
 - Kontratë Prokurimi me objekt “**Kancelari**”
 - Vlera Totale e Kontrates: 227 880 Lekë me Tvsh.
 - Kontratë Prokurimi me objekt “**Derrase Pisha**”
 - Vlera Totale e Kontrates: 380 160 Lekë me tvsh.
 - Kontratë Prokurimi me objekt “**Petavra pisha**”
 - Vlera Totale e Kontrates: 653 520 Lekë me tvsh.
 - Kontratë Prokurimi me objekt “**Materiale për restaurimin e Shen Triadhes**”
 - Vlera Totale e Kontrates: 96 600 Lekë me tvsh.
 - Kontratë Prokurimi me objekt “**Materiale për restaurimin e Ikonave**”
 - Vlera Totale e Kontrates: 96 600 Lekë me tvsh.
 - Kontratë Prokurimi me objekt “**Blerje vegla pune**”
 - Vlera Totale e Kontrates: 44 830 Lekë me tvsh.
 - Kontratë Prokurimi me objekt “**Leter katerma**”
 - Vlera Totale e Kontrates: 216 936 Lekë me tvsh.
 - Kontratë Prokurimi me objekt “**Blerje squfur**”
 - Vlera Totale e Kontrates: 36 000 Lekë me tvsh.
 - Kontratë Prokurimi me objekt “**Arkeologu i vogel**”
 - Vlera Totale e Kontrates: 31 910 Lekë me tvsh.
 - Kontratë Prokurimi me objekt “**Antimole**”
 - Vlera Totale e Kontrates: 95 000 Lekë me tvsh.
 - Kontratë Prokurimi me objekt “**Materiale promovimi**”
 - Vlera Totale e Kontrates: 26 000 Lekë me tvsh.
 - Kontratë Prokurimi me objekt “**Mirembajtje ëëbsite**”
 - Vlera Totale e Kontrates: 36 000 Lekë me tvsh.
 - Kontratë Prokurimi me objekt “**Libra për shkollat**”
 - Vlera Totale e Kontrates: 34 940 Lekë me tvsh.
 - Kontratë Prokurimi me objekt “**Blerje materiale për zdruckhtaret**”
 - Vlera Totale e Kontrates: 48 293 Lekë me tvsh.
 - Kontratë Prokurimi me objekt “**Sherbime desinfektimi**”
 - Vlera Totale e Kontrates: 60 000 Lekë me tvsh.
 - Kontratë Prokurimi me objekt “**Sherbime printimi**”
 - Vlera Totale e Kontrates: 36 000 Lekë me tvsh.
 - Kontratë Prokurimi me objekt “**Blerje skeleri punimesh**”
 - Vlera Totale e Kontrates: 189 000 Lekë me tvsh
- Etj.



Gjithashtu gjatë vitit 2025 kemi realizuar edhe nje procedure konkurrimi publike me objekt "Konservim dhe restaurim ne Kullat 23-24 dhe 24-1, kurtinat midis tyre dhe oborri i fortifikuar", faza e pare, lagjja Kala, Berat. Vlera e kontratës ka qënë 5 335 999 pa tvsh.

d. Realizimi i buxhetit per vitin 2025

ART	PLAN VJETOR	Buxheti I Rishikuar 2025 (A)	Shpenzime Faktike 12 mujori 2025 (B)	Gjendje	Shpenzi
					me ne % (B/A)
600	18,800,000	21,800,000	20,474,710	1,325,290	95%
601	3,150,000	3,450,000	3,414,871	35,129	99%
602	7,000,000	7,000,000	6,662,768	337,232	96%
606	24,000	137,200	-	-	0%
231		5,871,000	5,805,841	65,159	99%
Totali	28,974,000	38,258,200	36,358,190	1,762,810	

e. Aktivitete të institucionit dhe projekte të financuara nga buxheti i shteti (604)

Në përmbushjen e misionit tonë për promovimin dhe edukimin lidhur me trashëgiminë kulturore materiale dhe jo materiale, DRTK Berat gjatë vitit 2025, ka realizuar një sërë aktivitesh, promovime dhe ekspozita sic paraqiten në tabelën e mëposhtme:

NR	TITULLI I AKTIVITETIT	PERIUDHA	VLERA E FINANCIMIT	PRODUKTI I PËRFITUAR (PËRSHKRIM I PRODUKTIT TË PËRMBLEDHURA NË 2-3 FJALI)
1	Veprimtari “Edukimi nëpërmjet kujtesës historike”	Janar 2025		Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Përkujtimit të Viktimave të Holokaustit, shkolla e mesme “Kristaq Capo” organizoi veprimtarinë “Edukimi nëpërmjet kujtesës historike”. DRTK Berat u bë pjesë e kësaj veprimtarie me prezantimin e disa paneleve fotografike dhe dhurimin



				<p>për bibliotekën e shkollës të librit “Hebrenjtë e Beratit” të autorit Simon Vrusho.</p> <p>Nëpërmjet përkujtimit të kësaj dite jo vetëm ndërgjegjësohemi për pasojat e ngjarjeve të tilla por edhe përforcojmë përgjegjësinë kolektive për të luftuar urrejtjen dhe diskriminimin.</p>
2	Veprimtari në shkollën “28 Nëntori” mbi vlerat e trashëgimise kulturore.	Janar 2025		<p>Orë edukimi kulturor mbi vlerat e trashëgimise kulturore në shkollën “28 Nëntori”.</p> <p>Roli i të rinjve mbi ruajtjen dhe promovimin e ketyre vlerave. Ne perfundim te takimit u shperndane fletepalsoje informuese per monumentet ne qytetine e Beratit</p>
3	Aktivitet- “Trashëgimia Kulturore përmes syve të nxënësve” në shkollën 9 vjecare Dyshnik.	Shkurt 2025		<p>U zhvillua takimi ne shkollën 9 vjecare Dyshnik ku Trashëgimia Kulturore përmes syve të nxënësve ishte tema e takimit. Një udhëtim edukativ mes monumenteve qe ruajne historine dhe identitetin tone!</p> <p>Diskutime dhe opinionet e te rinjve rreth vlerat te trashëgimise dhe ruajtjes se tyre.</p>



4	Aktivitet- “Trashëgimia Kulturore përmes syve të nxënësve” në shkollën e Bashkuar Starove.	Shkurt 2025		U zhvillua takimi ne shkollën e Bashkuar Starove ku Trashëgimia Kulturore përmes syve të nxënësve ishte përsëri tema e takimit. Një udhëtim edukativ mes monumenteve qe ruajne historine dhe identitetin tone!
5	Punetori “Veshjet Tradicionale” në shkollën 9 vjeçare të qytetit “Zihni Toska”	Mars 2025		Veprimtaria u zhvilluan ne shkollën 9 vjeçare të qytetit “Zihni Toska”. Gjatë saj nxënësit nëpërmjet materialeve fotografike u njohen me veshjet popullore si element shprehes dhe identifikues i kultures popullore. Aktiviteti synoi edukimin dhe percjelljen e tradites.
6	Punetori “Veshjet Tradicionale” në shkollën 9 vjeçare të qytetit “Mehmet Ali Vrioni”.	Mars 2025		Veprimtaria u zhvilluan ne shkollën 9 vjeçare të qytetit “Mehmet Ali Vrioni”. Gjatë saj nxënësit nëpërmjet materialeve fotografike u njohen me veshjet popullore si element shprehes dhe identifikues i kultures popullore. Aktiviteti synoi edukimin dhe percjelljen e tradites.
7	Ekspozitë në katedralen “Fjetja e Hyjlindëses” e	Prill 2025		Ekspozitë në një nga monumentet më



	shek të XVIII, sot muzeu Kombëtar Ikonografik “Onufri”.			përfaqësuese të trashëgimisë kulturore, në katedralen Fjetja e Hyjlindëses e shek të XVIII, sot muzeu Kombëtar Ikonografik “Onufri”. Për vizitorët e shumtë që frekuentojnë këtë muze hapëm ekspozitën me temë: “Objekte ndërtimore me vlera historiko-kulturore, që mungojnë në qytetin e Beratit, me autorë Dritan Çoku. Gjithashtu, kjo ekspozitë bashkëshoqërohej me foto të vjetra historike bardh e zi me pamje të qytetit të vjetër të Beratit pjesë e arkivës së Qendrës Muzeore Berat.
8	Aktivitet me nxënësit e shkollës artistike “Ajet Xhindole”- Folklori Yne.	Prill 2025		Folklori Yne, pasuri e çmuar. Nxënësit e shkollës artistike “Ajet Xhindole” udhëhequr nga mësuesja e lëndës letërsi. M. Vehollari në bashkëpunim me DRTK jetëzuan brenda mjediseve të shkollës odën Beratase ku u shpalos mikëpritja, këngët, vallet, dhe punime në artin pamor.
9	Punëtori edukative “Monumentet e qytetit tim” me nxënësit e shkollës “Mehmet Ali Vriani”	Prill 2025		Gjatë punëtorisë edukative “Monumentet e qytetit tim” nxënësit e shkollës “Mehmet Ali Vriani” u njohën me monumentet e kulturës së qytetit përmes vizatimit dhe ngjyrosjes. Duke përdorur imazhet si referencë ata i dhanë jetë



				me ngjyra objekteve historike duke zhvilluar kreativitetin dhe njohurite për Trashëgiminë Kulturore
10	Aktivitet –Njohja mbi teknikën e restaurimit, me nxënësit e gjimnazit “Kristaq Çapo”.	Prill 2025		Laboratori i Restaurimit të Veprave të Artit, aty ku nxënësit bëhen ura mes së kaluarës dhe së ardhmes, përmes artit të rikthyer në jetë. Njohja me tekniken e resaturimit dhe vlerat e nje vepre arti. Rëndesia per te kryer restaurimin ne mënyrën e duhur per te mos humbur vlerat e vepres. Me nxënësit e gjimnazit “Kristaq Çapo”.
11	Hartimi dhe plotesimi i kartelave të Trashegimise jo Materiale.	Maj 2025		Kërkimi në terren i informacioneve mbi dukuri që gjallojne në qarkun e Beratit. Plotesimi i kartelave mbi dukuri si festa fetare e Rrëshajeve, tradita e Dollisë dhe Vallja dyshe e Beratit.
12	Aktivitet–Edukimi Kulturor- Takim me nxënësit e shkollës Paftal	Maj 2025		Takim informues dhe sensibilues mbi trashegimine kulturore dhe rolin e te rinjve ne mbrojtjen e vlerave te trashegimise. Takimi u zhvillua me nxënësit e shkollës Paftal ku u shpërndan fletepalosje dhe kartolina promovuese.
13		Qershor 2025		Ekspozita fotografike



	Ekspozita fotografike “Berati në sytë e udhëtarëve të huaj”			“Berati në sytë e udhëtarëve të huaj”. DRTK Berat solli për vizitorët e Qendrës Mesjetare një ekspozitë me piktura, akuariele, gravura të disa prej artistëve europian që kanë vizituar Beratin që prej vitit 1818. Në këto punime pasqyrohej arkitektura, peisazhi dhe jeta sociale e qytetit.
14	Prezantimi i librit “Historia dhe arkitektura e banesës Lluci Velagoshti”, me autor Dritan Çoku.	Shtator 2025		<p>DRTK Berat në bashkëpunim me Bashkinë Berat dhe Bibliotekën “Vexhi Buharaja” organizuan prezantimin e librit “Historia dhe arkitektura e banesës Lluci Velagoshti”, me autor Dritan Çoku.</p> <p>Ky botim është rezultat i një pune kërkimore individuale dhe dyvjeçare të autorit, i cili i kushton vëmendje të veçantë një banese karakteristike me çardak të shekullit XVIII – një objekt me vlera të spikatura për trashëgiminë kulturore shqiptare.</p> <p>Prezantimi i librit u shoqërua edhe me një ekspozitë personale, e përbërë nga 12 panele me 24 skica bardhë e zi të grafikës artistike. Këto vizatime përfaqësojnë pamje të objekteve të ndryshme arkitektonike, pjesë e ansambleve urbane</p>



				me vlera historiko-kulturore, që sot nuk ekzistojnë më në qytetin e Beratit.
15	Ekspozitë fotografike “Berati në Gur dhe Histori”.	Shtator 2025		<p>Në Ditën Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore, DRTK Berat organizoi ekspozitën fotografike “Berati në Gur dhe Histori”.</p> <p>15 panele me foto prezantuan një pjesë të trashëgimisë se pasur arkitektonike të qytetit të Beratit.</p> <p>Trashëgimia arkitektonike prezantohet si urë lidhëse mes së kaluarës dhe të ardhmes, kujtesës dhe modernitetit.</p> <p>Aktiviteti u zhvillua në qendren mesjetare dhe të pranishëm ishin: përfaqësues të qeverisjes vendore, Prefekti i Qarkut Berat, përfaqësues të institucioneve arsimore, kulturore dhe vizitorë vendas e të huaj.</p>
16	Aktivitete në kuadër të “Ditëve Evropiane të Trashëgimisë”	Shtator 2025		Në kuadër të Ditëve Evropiane të Trashëgimisë, DRTK Berat, organizoi një sërë veprimtarish me karakter edukues dhe kulturor. Aktivitete të ndryshme, nga punëtoritë shumëngjyrëshe që nxitën krijimtarinë e të rinjve, deri te takimi njohës mbi vlerat



				<p>dhe pasuritë kulturore të qytetit, sollën një qasje të brezit të ri në procesin e njohjes, promovimit dhe ruajtjes së trashëgimisë sonë.</p> <p>Takimet u zhvilluan në shkollat 9 vjeçare të qytetit: Shkolla 28 Nentori dhe Zihni Toska.</p>
17	"Mbremja Poetike" me nxenesit e shkolles 9 vjeçare "Zihni Toska".	Tetor 2025		<p>Prane Qendres Mesjetare u zhvillua "Mbremja Poetike" me nxenesit e shkolles 9 vjeçare "Zihni Toska". Nxënesit lexuan dhe interpretuan vepra te autoreve shqiptar.</p> <p>Aktiviteti u ndoq nga komuniteti i qendres mesjetare dhe shkolles.</p>
18	Aktivitet-Takim me librin, me nxenesit e shkolles "Jani Dodi" Sinje.	Tetor 2025		<p>Takimi i dyte me librin u zhvillua në qendren administrative Sinje. Veprimtaria shkriu ne nje traditat, folklorin dhe zakonet e zonës e pasur ne trashegimi.</p> <p>Takimi u zhvillua me nxenesit e shkolles "Jani Dodi" Sinje.</p>
19	Aktivitet- Festat Kombëtare të Nëntorit, me shkollën e mesme të bashkuar "Ajet Xhindole".	Nëntor 2025		<p>Në atmosferën e Festave Kombëtare, fëmijët e talentuar të shkollës së mesme të bashkuar "Ajet Xhindole" i dhanë jetë motiveve tradicionale duke</p>



				<p>rikrijuar çdo detaj të kostumeve popullore përmes qendisjes dhe pikturës. Punimet erdhën si një ndërthurje e kreativitetit me trashëgiminë. Në duart e tyre, tradita rifiton ngjyra dhe kuptim të ri, duke u bërë dëshmi e vlerave që kalojnë nga një brez në tjetrin.</p>
20	<p>Aktivitet- “Dita e Alfabetit”</p>	<p>Nëntor 2025</p>		<p>Në kuadër të Festave Kombëtare dhe Ditës së Alfabetit zhvilluam një takim të rëndësishëm me një përfaqësues të një familjeje rilindase, Z. Llambi Goxhomane në prani të një grupi fëmijësh, me fokus tek alfabeti dhe gjuha shqipe. Gjatë bashkëbisedimit u theksua roli i gjuhës amtare si shtyllë e identitetit kombëtar dhe rëndësia e transmetimit të këtyre vlerave tek brezat e rinj. Biseda ngjalli kureshtje te fëmijët të cilët u njohën më afër me historinë e gjuhës sonë.</p>
21	<p>Vizitë e veçantë mësimore në Laboratorin e Restaurimit të Veprave të Artit.- me nxënësit e shkollës “1 Maji”</p>	<p>Dhjetor 2025</p>		<p>DRTK Berat në bashkëpunim me ZVAP Berat , u mundësuan nxënësve të shkollës “1 Maji”, që ndjekin programin “Arte dhe Zeje”, një vizitë të veçantë</p>



				mësimore në Laboratorin e Restaurimit të Veprave të Artit. Ata u njohën me vlerat e vecanta artistike dhe kulturore të ikonave dhe veçanërisht me mjeshtërin dhe rëndësinë e restaurimit të tyre. Gjatë vizitës nxënësit u njohën konkretisht me punën që janë duke zhvilluar restauratorët e DRTK-Berat në restaurimin e ikonave.
22	Aktivitet mbi Trashëgimie Kulturore dhe vlerat e saj -me nxënësit e shkolles Uznove.	Dhjetor 2025		Leksion i hapur mbi Trashëgimie Kulturore dhe vlerat e saj me nxenesit e shkolles Uznove.

3. MBIQYRJE, KOLAUDIM DHE MONITORIME TE KRYERA

Specialistët monitorojnë në mënyrë periodike monumentet e kulturës në qarkun Berat në kuadër të mbrojtjes së vlerave që ato mbartin dhe parandalimin e tjetërsimit dhe degradimit të tyre.

Gjatë vitit 2025 janë kryer kontrole të shpeshta para sezonit turistik, ku mbi 15 qytetarë janë informuar për legjislacionin e trashëgimisë kulturore që duhet zbatuar për realizimin e punimeve .

Nga verifikimet në terren janë konstatuar situata emergjente në muratura guri dhe streha porte për të cilat janë marr masat e menjëhershme.

Specialistët e DRTK Berat gjatë vitit 2025 kanë realizuar mbikqyrje punimesh në objektet:

1	Konservim dhe restaurim i kullave 23-24, 24-1, kurtinat midis tyre dhe oborri i fortifikuar, Kalaja e Beratit"-Faza e pare e cila përfshin restaurimin e kullave 24-1 dhe			KKTKM
---	---	--	--	-------



	kurtinen midis tyre.		
2	Miratim i projektit “Restaurimi/rijetëzimi i banesës së familjes Bitri, lagjja Kala, Berat”, monument kulture i kategorisë së II-të, me aplikues z. Ergys Çausi dhe zhvillues z. Artan Bitri.	Nr. 342, datë 13.09.2024	KKTKM
3	Miratimin e projektit “Restaurim dhe rijetesim i banesës së z. Ramazan Kapllani M-083, lagje Mangalem”, Monument Kulture i Kategorisë së II-të, Bashkia Berat, me aplikues Znj. Valbona Lufta dhe zhvillues Z. Ramazan Kapllani.	Nr. 504, datë 06.12.2024	KKTKM
4	Miratimin e projektit “Restaurimi dhe përshtatje interieri pa ndryshim fasade, vëllimi dhe sipërfaqe, i ish banesës së z. Lili Vrusho në pronësi të znj. Serena Pajo dhe z. Anduen Pajo M-013, lagjja Mangalem, Berat”, monument kulture i kategorisë së II-të, me aplikues dhe zhvillues znj. Serena Pajo.	Nr. 24, datë 17.01.2025	KKTKM